

UDHËZIME RRETH THIRRJES PUBLIKE
për përzgjedhjen e një personi juridik që ushtron veprimtari ose posedon licencë
për grumbullimin dhe/ose transportin, përpunimin, riciklimin dhe asgjësimin e mbetjeve

I. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut duhet të zgjedhë person juridik që kryen veprimtari ose ka licencë për grumbullimin dhe/ose transportimin, përpunimin, riciklimin dhe asgjësimin e mbeturinave për sendet e luajtshme të cilat për shkak të vjetërsimit, mospërdorimit ose vjetërsisë teknologjike nuk përdoren nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

II. PËRSHKRIMI I SUBJEKTIT TË THIRRJES PUBLIKE

Subjekt i thirrjes publike janë sendet e luajtshme të cilat për shkak të vjetërsimit, mospërdorimit apo vjetërsisë teknologjike nuk shfrytëzohen nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe gjenden në lokalitetet e shënuara në thirrjen publike si në vijim:

1	Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shërbimi Qendror, rr.Vasill Gjorgov nr.43, Shkup
2	rr.Sava Kovaçeviq p.n. Shkup, (magazina në Kisella Vodë)
3	3 Qendra e Punësimit Berovë, Rr. Mareshali Tito 19, Berovë
4	4 Qendra e Punësimit Manastir, rr.Gjorçe Petrov p.n. Manastir
5	5 Qendra e Punësimit Vallandovë, Rruga 4 Korriku nr. 5, Valandovë
6	6 Qendra e Punësimit Veles, Rruga Petre Përliçkov 34, Veles
7	7 Qendra e Punësimit Vinicë, Mareshali Tito p.n. Vinicë
8	8 Qendra e Punësimit Gjevgjeli, Rr. Boris Karpuzo 1, Gjevgjeli
9	9 Qendra e Punësimit Gostivar, rr.Sheshi Vardar nr.1, Gostivar
10	10 Qendra e Punësimit Dibër, rr.8 Shtatori nr.68, Dibër
11	11 Qendra e Punësimit Dellçevë, Bul.Makedonija p.n. Dellçevë
12	12 Qendra e Punësimit Demir Hisar, Mareshali Tito p.n. Demir Hisar
13	13 Qendra e Punësimit Kavadar rr.7 Shtatori, nr.74, Kavadar
14	14 Qendra e Punësimit Kërçovë Bul.Osloboduvanje nr.39 Kërçovë
15	15 Qendra e Punësimit Koçani rr. Veljko Vlahoviq 1.Koçani
16	16 Qendra e Punësimit Kratovë, rr.Goce Dellçev nr.36, Kratovë
17	17 Qendra e Punësimit Kriva Pallankë, rr.Mareshali Tito 181, Kriva Pallankë
18	18 Qendra e Punësimit Krushevë, rr.Nikolla Gjurmoviq p.n. Krushevë
19	19 Qendra e Punësimit Kumanovë, rr.Todor Vellkov p.n. Kumanovë
20	20 Qendra e Punësimit Makedonski Brod, rr.Partizanska nr.10, Makedonski Brod
21	21 Qendra e Punësimit Negotinë, Rr.Pekares nr.5 Negotinë
22	22 Qendra e Punësimit Prilep, rr. Llado Llapecot nr.100 Prilep
23	23 Qendra e Punësimit Probishtip, rr.Miro Baraga p.n. Probishtip
24	24 Qendra e Punësimit Radovish, rr.Mareshali Tito p.n. Radovish
25	25 Qendra e Punësimit e Qytetit të Shkupit, rr. Vasil Gjorgov nr.41, Shkup
26	26 Qendra e Punësimit Strumicë rr.1 Maji nr.36, Strumicë
27	27 Qendra e Punësimit Tetovë rr. Blagoja Toska nr.23,Tetovë
28	28 Qendra e Punësimit Shtip, rr. Goce Dellçev nr.91, Shtip

Sendet e luajtshme që janë objekt i thirrjes publike përshkruhen në detaje në Shtojcën 1, me emërtimin/përshkrimin e sendit të luajtshëm dhe sasinë.

Personi juridik i përzgjedhur është i obliguar që sendet e luajtshme që i nënshtrohen thirrjes publike t'i marrë nga lokaliteti i caktuar dhe t'i përzgjedhë dhe transportojë si mbeturina në mënyrën e duhur, në pajtim me Ligjin për shfrytëzimin dhe asgjësimin e sendeve në pronësi shtetërore dhe sendeve në pronësi komunale, Ligjin për menaxhimin e mbeturinave dhe Ligjin për menaxhimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike dhe mbeturinave elektrike dhe elektronike.

III. KRITERET E PËRZGJEDHJES

Kriter për përzgjedhjen e personit juridik është marrja në dorëzim e sendeve të luajtshme që i nënshtrohen thirrjes publike në një kohë sa më të shkurtër, pa kompensim.

Nëse dy e më tepër subjekte juridike ofrojnë të njëjtin afat për marrjen në dorëzim të sendeve të luajtshme që i nënshtrohen thirrjes publike, në atë rast do të përzgjedhet personi juridik i cili i pari ka paraqitur kërkesë për pjesëmarrje në Arkivin/Regjistrin e Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nëse është pranuar vetëm një aplikim për pjesëmarrje nga ana e një personi juridik, Agjencia e Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut do ta përzgjedhë atë person juridik nëse ka dorëzuar ofertë të pranueshme, përkatësisht nëse i plotëson kushtet ligjore dhe ka lejet e nevojshme.

IV. E DREJTA PËR PJESËMARRJE

Të drejtën e aplikimit për pjesëmarrje e kanë të gjithë personat e interesuar juridikë të regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë që është objekt i thirrjes publike, respektivisht, që kryejnë veprimtari ose kanë licencë për grumbullimin dhe/ose transportimin, përpunimin, riciklimin dhe asgjësimin e mbetjeve.

Dokumentet e nevojshme që duhet dorëzuar për aplikim:

- Aftësia për të kryer veprimtari profesionale:

- dokument për aktivitetin e regjistruar (jo më i vjetër se 6 muaj);
- statusi aktual (jo më i vjetër se 6 muaj)
- leje të vlefshme për grumbullimin dhe/ose transportimin, përpunimin, riciklimin dhe asgjësimin e mbetjeve (mbeturina druri, metali, plastike dhe elektrike/elektronike), të lëshuar nga organi kompetent.

- Aftësia teknike dhe profesionale:

- deklaratë se ka mjete të përshtatshme transporti për kryerjen e objektit të thirrjes publike;
- deklaratë se për kryerjen e pandërprerë të shërbimit, do të ketë një numër të mjaftueshëm personash do të jenë në dispozicion në çdo kohë për të kryer shërbimin që është objekt i thirrjes publike.

Dokumentet për aftësinë për të kryer veprimtari profesionale, si dhe dokumentet për aftësinë teknike dhe profesionale, dorëzohen si shtojcë në origjinal ose në kopje të vërtetuar nga personi juridik me nënshkrimin e personit përgjegjës dhe me shënimin "E besueshme me origjinalin" - në secilën faqe të shtojcës.

Nëse personi juridik i përzgjedhur refuzon lidhjen e kontratës, në atë rast lidhja e kontratës do t'i ofrohet personit juridik të radhës që ka paraqitur kërkesë me ofertë të pranueshme për pjesëmarrje dhe dokumentacion përkatës të parashikuar në thirrjen publike.

V. PYETJE DHE SQARIME

Informata më të hollësishme mund të merren çdo ditë pune nga ora 09:00 deri në ora 15:00 në objektin e Shërbimit Qendror të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, rruga "Vasil Gjorgov" nr.43 - Shkup.

Telefoni i kontaktit lidhur me thirrjen publike: 02/3111-850, e-mail: info@av.gov.mk

VI. AFATI DHE MËNYRA E DORËZIMIT TË APLIKACIONIT PËR PJESËMARRJE

Afati i fundit për paraqitjen e aplikimit për pjesëmarrje është 29.06.2022 viti.

Aplikimet mund të dorëzohen:

- me postë në adresën: Agjencia e Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, rr. "Vasil Gjorgov" nr.43 – Shkup, ose

- drejtpërdrejt në Arkivin / Regjistrin e Shërbimit Qendror të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. në rrugën "Vasil Gjorgov" nr.43 - Shkup.

Kërkesa e paraqitur pas skadimit të afatit të fundit, refuzohet si e vonuar.

Personi juridik e dorëzon kopjen origjinale të kërkesës me dokumentet në një zarf të mbyllur me shënimin "MOS E HAP".

Shembull se si duhet të duket pjesa e përparme e zarfit të mbyllur për personat juridik që do të aplikojnë për pjesëmarrje në thirrjen publike me postë ose direkt në zyrën e regjistrimit të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut:

"MOS E HAP" Për një thirrjen publike për përzgjedhjen e një personi juridik që ushtron veprimtari ose zotëron lejen e grumbullimit dhe/ose transportin e mbetjeve Drejtuar: Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut Rruga Vasil Gjorgov nr. 43 1000 Shkup

VII. LIDHJA E KONTRATËS

Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut pas skadimit të 3 ditëve nga dita e marrjes së vendimit për përzgjedhjen e personit juridik që ushtron veprimtari ose ka licencë për grumbullimin dhe/ose transportimin e mbeturinave dhe i cili do të bëjë marrjen e sendeve të luajtshme që janë objekt i thirrjes publike, do ta njoftojë me shkrim personin juridik të përzgjedhur.

Njëkohësisht, Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut do t'i informojë për përzgjedhjen të gjitha subjektet juridike që kanë marrë pjesë në thirrjen publike.

VIII.DETYRIMET E PERSONIT JURIDIK TË PËRZGJEDHUR PAS LIDHJES SË KONTRATËS

Personi juridik me të cilin Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të lidhë marrëveshje është i obliguar që sendet e luajtshme që i nënshtrohen thirrjes publike t'i marrë nga objektet e Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (respektivisht, nga lokalitetet e shënuara në thirrjen publike) dhe të njëjtat t'i përzgjedhë dhe t'i transportojë në mënyrën e duhur, në përputhje me dispozitat ligjore.

Me rastin e marrjes në dorëzim të sendeve të luajtshme që i nënshtrohen thirrjes publike nga personi juridik i përzgjedhur, Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe personi juridik i përzgjedhur janë të obliguar që të bëjnë dorëzimin me procesverbal të sendeve të luajtshme në fjalë.

AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË SË VERIUT